



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA HIMARË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 6447/prot.

Himarë, më 14.09. 2026

**NJOFTIM**

**Lënda :** Njoftim për mbajtjen e mbledhjes jashtë radhe të Këshillit të Bashkisë Himarë me kërkesë të Anëtarëve të Këshillit.

Të nderuar këshilltarë,

Ju njoftoj se ditën e hënë më datë 14.09.2026, ora 19:00 në sallën “ Neço Muko” Himarë do të zhvillohet mbledhja jashtë radhe e Këshillit të Bashkisë Himarë, e thirrur nga 1/3 e anëtarëve të Këshillit, bazuar në nenin 53, pika 3, shkronja b, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

- Miratimi i rendit të ditës.

1. Paraqitja e evidentimit paraprak të kryer deri në datën e mbledhjes ose nëse procesi ka përfunduar, evidentim të plotë të dëmeve të shkaktuara nga zjarret duke përfshirë sipërfaqet e prekura, numrin e banesave dhe familjet e prekura, numrin e rrënjëve të ullinjve dhe pemëve të tjera të dëmtuara, dëmet në bletari, bagëti, sipërfaqet pyjore e bujqësore, infrastrukturë dhe pasuri të tjera.
2. Paraqitja e plotë e fondeve dhe kapaciteteve që Bashkia Himarë ka për mbrojtjen nga zjarri dhe përballimin e dëmeve, duke evidentuar fondin e parashikuar në buxhet, shumën aktuale në dispozicion, shumën e përdorur gjatë vitit 2026, si dhe shpenzimet e kryera për blerjen e automjeteve zjarrfikëse, mjeteve dhe paisjeve të tjera, veshjeve mbrojtëse dhe cdo zëri tjetër të lidhur me shërbimin zjarrfikës dhe mbrojtjen civile.



Sekretari

Zaho Dedi